



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 135

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 2 gusht 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 120, datë 17.7.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 463, datë 10.12.2020, “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”, të ndryshuar..... 16269
Urdhër i Kryeministrit nr. 133, datë 30.7.2024	Për delegim kompetence..... 16284
Urdhër i Kryeministrit nr. 140, datë 1.8.2024	Për delegim kompetence..... 16284
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 567, datë 25.7.2024	Për përditësimin e urdhrit të ministrit nr. 275, datë 5.5.2023, “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar..... 16284
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 120, datë 10.7.2024	Autorizim i ndihmës shtetërore “Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2024”..... 16286
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 77/13, datë 29.7.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugëve ‘Faik Pajuni’ dhe ‘Alush Lleshanaku’ në ZK 8521, Bashkia Elbasan”..... 16289
Njoftim i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 292/32, datë 30.7.2024	Mbi mundësinë e shpërblimit në natyrë të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për zbatimin e projektit të Portit të Ri Tregtar të Integruar të Durrësit në Porto-Romano”..... 16291

**UDHËZIM I PËRBASHKËT****Nr. 120, datë 17.7.2024**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 463, DATË
10.12.2020, “PËR PËRCAKTIMIN E
INSTITUCIONEVE DHE ORGANEVE QË
MARRIN TË DHËNA PERSONALE NGA
SHËRMBIMI I GJENDJES CIVILE, SI DHE
MËNYRËN, LLOJIN DHE SASINË E
INFORMACIONIT QË DUHET TË
MARRIN”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikave 2, 2/1 dhe 3 të nenit 3, pikës 2 të nenit 60 të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile” i ndryshuar, si dhe shkronjës “k”, të pikës 1, të nenit 31 dhe nenit 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Ministri i Brendshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZOJNË:

Në aneksin I, pjesë përbërëse e udhëzimit nr. 463, datë 10.12.2020, “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijojnë:

a) pikat 1, 6, 12, 20, 22, 27, 31 dhe 32, të aneksit I, ndryshohen me përmbajtjen sipas listës së institucioneve që marrin informacion, bazës ligjore përkatëse, llojit dhe sasisë së informacionit që jep shërbimi i gjendjes civile dhe mënyrës së vënies në dispozicion të këtij informacioni, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) pas pikës 37, të aneksit I, shtohen pikat 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49 dhe 50.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla**

**KOMISIONER PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi**



MINISTRIA E BRENDSHME
KOMISIONERI PËR TË DRETËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

ANEKSI II

LISTA E INSTITUCIONEVE QË MARRIN INFORMACION, BAZA LIGJORE PËRKATËSE, LLOJI DHE SASIA E INFORMACIONIT QË JEP SHËRBIMII
GJENDJES CIVILE DHE MËNYRA E VËNIES NË DISPOZICION TË KËTILJ INFORMACIONI

NR.	SUBJEKTET QË MARRIN TË DHËNA	BAZA LIGJORE	TË DHËNAT PERSONALE QË DUHET TË JEPEN NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE NË PËRPUTHJE ME LEGJISLACIONIN PËRKATËS PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	MËNYRA E VËNIES NË DISPOZICION TË INFORMACIONIT TË KËRKUAR
1.	Agjencia për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyerë (AMGKP)	Ligji nr. 55/2023 "Për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyerë"	Të dhënat për personat debitorë si më poshtë: - emër; - mbiemër, - numri personal; - emri i babait; - datëlindje; - vendbanimi aktual dhe regjistrime të mëparshme (adresa); - të dhënat familjare dhe të vdekjes për shtetasit që kanë ndërruar jetë;	Në mënyrë shkresore ose elektronike.



6.	Avokati i Popullit	Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar; - Neni 19 “Procedura e hetimit”; - Neni 20 “E drejta për të kërkuar informacione apo dokumente sekrete shtetërore”; Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar; - Nënsekioni II Procedura e Zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga avokatia Neni 31, “Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore” pikat 2, 3 dhe 4; - Nënsekioni II, Procedura e Zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Avokatia Neni 129, pikat 2, 3 dhe 4 “Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore”	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, por që kanë lidhje me hetimin. Të gjitha të dhënat e domosdoshme, përbërësit e gjendjes civile të subjekteve, kandidaturave që kanë shprehur pëlqimin për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe ndryshimeve në përbërësit e gjendjes civile.	Në formë shkresore, sipas kërkesës
-----------	---------------------------	--	--	------------------------------------

12.	Agjencia e Inteligjencës Financiare	Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, i ndryshuar. - neni 21 “Organizimi i autoritetit përgjegjës”; - neni 22 “Detyrat dhe funksionet e autoritetit përgjegjës”.	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numri personal; - atësi; - amësi; - datëlindje; - vendlindje; - gjendja civile; - gjinia; - lidhja me kryefamiljarin; - përbërja familjare aktuale dhe historike;	Në formë elektronike, përmes ndërrimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.
------------	--	--	---	--



20. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Ligji nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. - neni 19 “Kompetencat e Komisionerit”; - pika 1, germa n) dhe pika 2; - neni 22 “Kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje”; - neni 23 “Procedura për futjen e teknologjisë në zgjedhje dhe vendimmarrja”; - neni 27 “Zonat e administrimit zgjedhor”; - neni 45 “Përbërësit zgjedhorë”; - neni 46 “Lista e zgjedhësve”, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012, ndryshuar pika 2 dhe shtuar pika 3 me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020; - neni 48 “Përbajtja dhe formati i listës së zgjedhësve”; - neni 51 “Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë”; - neni 56 “Përgatitja dhe shpallja e listës së zgjedhësve”; - neni 61 “Mbikëqytja e hartimit të listave të zgjedhësve nga KQZ-ja”, pika 2 dhe pika 3. Aktet nënligjore, udhëzime dhe vendime të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. (Vendim nr.2, datë 31.10.2020 i Komisionit Rregullator).	Të dhënat e shtetasve, të cilët në datën e zgjedhjeve kanë mbushur 18 vjeç, të vlerësuara të domosdoshme për procesin zgjedhor, respektivisht si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numër personal; - emri i babait; - emri i nënës; - datëlindje; - të dhënat për vendbanimin, adresën; - gjininë e shtetasve votues; - shtetësia; - numri i qendrës së votimit; - adresa e qendrës së votimit; - letërnjoftimi i vlefshëm; - foto e votuesve.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
--	---	---	---



		Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” - neni 2 “Ndalimi për kandidim dhe për t’u zgjedhur në një funksion të lartë publik”; - neni 5 “Vetëdeklarimi dhe verifikimi i të dhënave”; - neni 8 “Organet kompetente për verifikimin dhe zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksione publike”; - neni 11 “Verifikimi i kushteve të ndalimit në rastin e krijimit të vakancave në Kuvend ose në këshillin bashkiak”; - vendimi nr. 17/2016, i Kuvendit të Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”;	Informacion për të gjitha të dhënat e vetëdeklaruar, të nevojshme për t’u verifikuar për subjektet, subjekte të kësaj ligji, sipas formularit të vetëdeklarimit. Informacion për ndryshimet e kryera në përbërësit e gjendjes civile.	Akses të plotë në RKGjC për auditët teknikienë.
--	--	---	---	--



22.	Ministria e Kulturës Drejtoria për të Drejtat e Autorit	Ligj nr. 8576, datë 3. 2. 2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - neni 28 “Bibliotekat publike”, pika 7. - Pika 8, germa a) e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 22.11.2023 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri i të dhënave të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to” dhe përcaktimin e elementeve të regjistrit të të dhënave të hapura për publikun, dokumentar elektronik”.	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë. Të dhënat si më poshtë: - numri personal; - atësia; - vendlindja; - datëlindja; - gjinia; - vendbanimi, adresa;	Në formë shkresore, sipas kërkesës. Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.
-----	--	---	--	---



27.	Organet e Qeverisjes Vendore Bashkitë dhe qarqet si njësi vetë-qeverisëse në Republikën e Shqipërisë Bashkia si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore Qarku si njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore	Ligji nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; - neni 48 “Përmbajtja dhe formati i listës së zgjedhësve”; - Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; - neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3 ku parashikohet e drejta dhe përgjegjësia e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve. Ligji nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”; - neni 59 “Kategoritë e përjashtuara” pika ç, ku parashikohen kategoritë e përjashtuara nga detyrimi për t’u angazhuar në operacione për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive. Ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesës. Të dhënat për fëmijët, shtetas të moshës nën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, respektivisht si vijon: - emër; - mbiemër; - numri personal; - emri i babait; - emri i nënës; - datëlindja; - vendlindja; - të dhënat për vendbanimin (adresën); - gjinia; dhe - shtetësia; Të dhënat e domosdoshme lidhur me përbërësit e gjendjes civile, të konsideruar të nevojshëm në përmbushje të funksioneve të organeve të qeverisjes vendore: - emër; - emër i babait; - mbiemër; - datëlindje; - të dhënat për vendbanimin (adresën) dhe të përbërjes familjare; - personat kujdestarë që kujdesen për personat me aftësi të kufizuara; - nënat me fëmijë nën 10 vjeç dhe prindërit e vetëm me fëmijë nën moshën 15 vjeç; - personat nën 18 dhe mbi 65 vjeç.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
-----	--	--	---	---



	Bashkitë Drejtoritë e Planifikimit Urban, Projekteve dhe Kadastrës, Sektori i Kadastrës	Ligji nr. 20/2022 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të kalimit të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. - neni 12 “Kushtet për kalimin në pronësi pa shpërbllim të tokës bujqësore” Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 126, datë 23.12.2022 “Për miratimin e platformës për aplikimet on line të fëmijëve në kopshte e cerdhe”	Të dhënat e përbërjes familjare më datë 01.08.1991 për personat që nuk kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjeve bujqësore, por kanë qenë banorë të fshatit ku gjendet toka bujqësore, objekt i kalimit të pronësisë. Për fëmijën në kopshte dhe cerdhe: - numri personal; - numri personal i anëtarëve të familjes së fëmijës në kopshte dhe cerdhe; - emri i babait; - emri i nënës; - mbiemri; - datëlindja; - vendlindja; - adresa, vendbanimi;	Në formë shkresore, sipas kërkesës Në formë elektronike
31.	Prefektët e qarqeve	Ligji nr. 107/2016 “Për prefektin e qarikut”; Ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar, neni 8; Udhëzimi nr. 1, datë 13.01.2010 i Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin” Udhëzimi nr. 2, datë 13.01.2010 i Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këto e kërkojnë individë a institucione”.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/akt nënligjor, vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.



32.	Prokuroria e Përgjithshme dhe organet e tjera të prokurorisë sipas organizimit të tyre	Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar - neni 2 “Respektimi i normave procedurale”. Ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; - neni 2 “Ndalimi për kandidim dhe për t’u zgjedhur në një funksion të lartë publik”; - neni 5 “Vetëdeklarimi dhe verifikimi i të dhënave”; - neni 8 “Organet kompetente për verifikimin dhe zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksione publike”; - neni 11 “Verifikimi i kushteve të ndalimit në rastin e krijimit të vakancave në Kuvend ose në këshillin bashkiak”; Vendimi nr. 17/2016, i Kuvendit të Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, që lidhen me cështjen në shqyrtim dhe qëllimin. Informacion për të gjitha të dhënat e vetëdeklaruar, të nevojshme për t’u verifikuar për subjektet, subjekte të këtij ligji, sipas formularit të vetëdeklarimit. Informacion për ndryshimet e kryera në përbërësit e gjendjes civile.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
-----	--	---	---	---



38.	Këshilli i Lartë Gjyqësor Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit	“Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, neni 135, pika 4. Ligji nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;	Të dhënat, përbërësit e gjendjes civile të shtetasve, respektivisht si vijon: - emri; - mbiemri; - emri i babait; - emri i nënës; - numri personal; - datëlindja; - vendlindja; - vendbanimi (adresa); - lidhja me kryefamiljarin; si dhe - të dhënat për vendbanimin e shtetasve me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; - certifikatë personale; - certifikatë familjare; - certifikatë vdekje; - certifikatë nga akti i lindjes. - certifikatë nga akti i martesës;	Në formë shkresore, sipas kërkesës, në formë elektronike për kërkesat që lidhen me vënien në dispozicion të dokumenteve, si dhe nëpërmjet identifikimit elektronik në RKGjC. Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.
39.	Byroja Kombëtare e Hetimit. Njësia e Posaçme Hetimore	Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, - neni 43, pika 2 dhe 3.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, që lidhen me çështjen në shqyrtim dhe me qëllimin.	Në formë elektronike, si dhe nëpërmjet identifikimit elektronik në RKGjC.



40.	Gjykata Kushtetuese Kolegji i Posacëm i Apelimit	Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë Aneksi i Kushtetutës për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas nenit Ç, pika 3. Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; - neni 45, kreu VII “Rregullat e përgjithshme të hetimit të çështjes”; - neni 50, pika 1 dhe neni 53.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj që lidhen me çështjen në shqyrtim dhe me qëllimin. Për çështje të rivlerësimit dokumentet, respektivisht si vijon: - certifikatë personale; - certifikatë familjare; - certifikatë martese; - certifikatë vdekje. Për subjektet e rivlerësimit dhe denoncuesit, të dhënat, përbërësit e gjendjes civile si vijon: - emër; - mbiemër; - emri i babait; - emri i nënës; - datëlindje; - numër personal; - vendbanimi (adresa);	Në formë elektronike, në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe nëpërmjet identifikimit elektronik në RKGjC.
41.	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	- Neni 179/b të Kushtetutës, pikat 1 dhe 2 - Aneksi Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve neni A dhe Ç; - Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Shtojca 1, Shtojca 2 dhe Shtojca 3. - neni 3 “Përkufizime”; - neni 30 “Objekti i vlerësimit të pasurisë”; - neni 31 “Fillimi i procedurës së vlerësimit të pasurisë”; - neni 32, “Deklarimi i pasurisë”; - neni 45 “Rregullat e përgjithshme të hetimit të çështjes”; - neni 49, “Mjetet për kërkimin e provës”; - neni 50 “Aksesi në informacion”;	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj që lidhen me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas shtojcës 3 të Deklaratës për Kontrollin e Figurës: - përbërësit e gjendjes civile dhe të dhënat familjare sipas historikut dhe ndryshimet në përbërësit e gjendjes civile; - të dhënat e vendbanimit sipas historikut të regjistrimit; - të dhënat për dokumentin e identitetit, letërnjoftimin;	Në formë shkresore, sipas kërkesës, në formë elektronike, si dhe nëpërmjet identifikimit elektronik në RKGjC.



42.	Agjencia e Mbikëqyrjes Policore	Vendimi nr. 188, datë 04.03.2015 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”. Urdhri nr. 272, datë 28.05.2015 i Ministrit të Punëve të Brendshme “Për procedurat e sigurimit të personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme”. - neni 3, pika 3 “autoritetet verifikuese”; - neni 12, gërmat “a” dhe “b”, kushtet për fillimin e verifikimit të sigurisë.	Të dhënat, përbërësit e gjendjes civile të shtetasve, të domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin, respektivisht si vijon: - emri; - mbiemri, (mbiemri para / pas martesë i shtetasve të gjinive femër / mashkull); - emri i babait; - emri i nënës; - numri personal; - datëlindja; - vendlindja; - të dhënat për vendbanimin (adresën); - statusi i gjendjes civile; - historiku i plotë i regjistrimit dhe ndryshimet në përbërësit e gjendjes civile, përfshirë dhe informacionin për datën kur janë kryer këto ndryshime; - kombësia sipas të dhënave arkivore të gjendjes civile, në rastet kur ky përbërës rezulton i dokumentuar;	Në formë elektronike, si dhe nëpërmjet identifikimit elektronik në RKGjC.
-----	--	--	--	--



43.	Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK)	Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, - neni 28, pika 3.	Të gjitha të dhënat e domosdoshmepërkryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, por që kanë lidhje me objektin e hetimit. Të gjithë përbërësit e gjendjes civile të shtetasve. Dokumentet: - certifikatë personale; - certifikatë familjare; - certifikatë martese; - certifikatë vdekje; - certifikatë historike e përbërjes familjare;	Në formë shkresore, sipas kërkesës, në formë elektronike, si dhe nëpërmjet identifikimit elektronik në RKGJC.
44.	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 32, pika 2.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme lidhur me përbërësit e gjendjes civile të shtetasve, që konsiderohen të nevojshëm për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, në ushtrimin e kompetencave të këtij institucioni, të vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë, që kanë lidhje me hetimin administrativ.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe elektronikisht.
45.	Agjencia e Trajtimin të Pronave	Ligji nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, neni 36, pika 1.	Të dhënat si më poshtë: - vendbanimi (adresa).	Në formë elektronike, përmes ndërrimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.
46.	Instituti i Shëndetit Publik	Ligji nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, i ndryshuar, neni 28; Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, neni 3;	Të dhënat si më poshtë: - për fëmijën: numri personal, emër, mbiemër, datëlindje; - për nënën: numri personal, emri dhe mbiemri; - për babain: numri personal, emri dhe mbiemri, në rastet kur është njohur atësia e fëmijës;	Në formë elektronike, përmes ndërrimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.



47.	Qendra e Shërbimeve Arsimore Drejtoria e Shërbimeve Arsimore	Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Kreu XII Shkeljet e kërkesave ligjore në fushën e arsimit parauniversitar - neni 66 Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale - neni 67 Mbrojtja e të dhënave personale Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 12, datë 27.07.2015 “Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë dhe nxënësve në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar, përmbajtjen e dosjeve të tyre personale, si dhe për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave kontaktuese të prindërve/kujdestarëve ligjorë të nxënësve”, i ndryshuar	Të dhënat për nxënësin: - numri personal; - emër; - mbiemër; - emri i babait; - shtetësi; - datëlindje; - vendlindje; - adresa, të dhënat për vendbanimin; - gjinia; - informacion mbi kujdestarin ligjor; Të dhënat për punonjësën arsimor: - numri personal; - emër; - mbiemër; - emri i babait; - shtetësi; - datëlindje; - vendlindje; - adresa, të dhënat për vendbanimin; - gjinia; Të dhënat për prindin/kujdestarin ligjor: - numri personal; - emër; - mbiemër; - shtetësi; - datëlindje; - adresa, të dhënat për vendbanimin; - gjinia;	Në formë elektronike, përmes ndërvëprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.
-----	--	---	--	--



48.	Shkolla e Magjistraturës Sektori i Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore	Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar; - Neni 262 Regjistrimi i konkurrentëve Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; - neni 29 “Thirrja për kandidatura” - neni 30 “Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve”	Të dhënat personale - emër; - mbiemër; - numër personal; - emri i babait; - datëlindje; - vendlindje; - vendbanimi (adresa);	Në formë elektronike, përmes ndërvëprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.
49.	Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)	Ligji nr. 97/23, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar; Ligji nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar;	Të dhënat personale - emër; - mbiemër; - numër personal; - datëlindje; - vendbanimi (adresa);	Në formë elektronike, përmes ndërvëprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.
50.	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)	Ligji nr. 10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar - neni 5 Personat e siguruar - neni 27 Regjistrimi dhe identifikimi i personave të siguruar	Të dhënat personale të personave që kanë ndërruar jetë: - zyra e gjendjes civile në bashki/njësi administrative; - emër; - mbiemër; - numër personal; - datëlindje;vendlindje; - emri i babait; - emri i nënës; - gjinia; - gjendja civile; - shtetësia; - vendbanimi (adresa); - data e vdekjes; - vendi i vdekjes; - shteti i vdekjes; - shkaku i vdekjes; - data e ç’regjistrimit;	Në formë elektronike, përmes ndërvëprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.

**URDHËR****Nr. 133, datë 30.7.2024****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në zbatim të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të neneve 22, pika 3, 28 e 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga Bashkimi Evropian znj. Julia Mata, në cilësinë e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të kësaj Agjencie.

2. Delegimi i kompetencave fillon me hyrjen në fuqi të këtij urdhri deri në plotësimin e pozicionit të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga Bashkimi Evropian.

3. Ngarkohet znj. Julia Mata, zëvendës drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga Bashkimi Evropian, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR**Nr. 140, datë 1.8.2024****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në zbatim të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të neneve 22, pika 3, 28 e 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, znj. Ermelinda Durmishi, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Programimit Strategjik në këtë Agjenci.

2. Delegimi i kompetencave fillon me hyrjen në fuqi të këtij urdhri deri në plotësimin e pozicionit të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.

3. Ngarkohet znj. Ermelinda Durmishi, drejtor i Drejtorisë së Programimit Strategjik në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR**Nr. 567, datë 25.7.2024**

PËR PËRDITËSIMIN E URDHRIT TË
MINISTRIT NR. 275, DATË 5.5.2023,
“PËR MIRATIMIN E LËNDËVE
VEPRUESE DHE PËRBËRËSVE TË
TJERË, NË PËRMBAJTJE TË PMB-ve”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve;

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 275, datë 5.5.2023, “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar, bëhet përditësimi me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) në pjesën B, të shtojcës 1, miratohet për shtim 1 (një) lëndë vepruese bazike, bashkëlidhur këtij urdhri;

b) rinovohet regjistrimi për 1 (një) lëndë vepruese kandidate për zëvendësim, bashkëlidhur këtij urdhri;

c) zgjaten afatet e regjistrimit për 4 (katër) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;



ç) hiqet 1 (një) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Përditësimi sipas shkronjës “c” të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.

3. Për PMB-të me përmbajtje të lëndës vepruese sipas shkronjës “ç”, çregjistrimi dhe heqja nga tregu të kryhen brenda afateve të përcaktuara sipas këtij urdhri, si dhe të njoftohen Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, si dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL.

Anila Denaj

**1. MIRATOHET PËR SHTIM NË PJESËN B, TË SHTOJCËS 1, LËNDA VEPRUESE
BAZIKE SI MË POSHTË:**

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Dispozita specifike
1	<i>Onobrychis vicifolia</i> (sainfoin) peleta të thara CAS No: Nuk disponohet CIPAC No: Nuk disponohet	Nuk disponohet	1000 g/kg. Papastërtitë përkatëse: Arsenik (1 g/kg), Kadmium (0,1 g/kg), Krom-VI (0,1 g/kg), Merkur (1 g/kg), Nikel (0,1 g/kg), Plumb (0,3 g/kg).	17 korrik 2024	<i>Onobrychis vicifolia</i> (sainfoin) peleta të thara do të përdoren në përputhje me kushtet specifike të përfshira në konkluzionet e raportit të rishikimit për <i>Onobrychis vicifolia</i> (sainfoin) peleta të thara (PLAN/2024/790 RR rev1) dhe në veçanti shtojcat I dhe II të tij.

**2. RINOVOHET REGJISTRIMI (RIREGJISTRIM) PËR LËNDËN VEPRUESE KANDIDATE
PËR ZËVENDËSIM SI MË POSHTË:**

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1.	Metconazole Nr CAS: 125116-23-6 (stereokimi i padeklaruar) CIPAC Nr: 706	(1RS,5RS:1R,5SR)-5-(4-chlorobenzyl)-2,2-dimethyl-1-(1H-1,2,4-triazol-1-ylmethyl)cyclopentanol	≥ 940 g/kg (shuma e cis- dhe trans-izomerëve) me nivel cis-metconazole (CI 354801) jo më pak se 800 g/kg dhe jo më shumë se 950 g/kg. Papastërtitë e mëposhtme nuk duhet të kalojnë nivelet e mëposhtme në materialin teknik: - toluen: 2 g/kg; - etilcikloheksan 2 g/kg.	1 shtator 2024	31 gusht 2031	Përdorimi duhet të jetë i kufizuar për përdoruesit profesionistë. Për zbatimin e parimeve uniforme, do të merren parasysh konkluzionet e raportit të rinovimit të metconazolit, dhe në veçanti shtojcat I dhe II të tij. Në vlerësimin e përgjithshëm, do të kushtohet vëmendje e veçantë për: - vlerësimin e ekspozimit të konsumatorit në lidhje me mbetjet që mund të jenë të pranishme në kulturat primare dhe kulturat pasuese të kultivuara në qarkullim; - mbrojtjen e operatorëve dhe kalimtarëve /banorëve; - mbrojtjen e organizmave ujorë. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme. Aplikanti të paraqesë informacion konfirmues gjatë aplikimit në lidhje me: 1. efektin e proceseve të trajtimit të ujit në natyrën e mbetjeve të pranishme në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, kur ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore nxirren për ujë të pijshëm; 2. profilin e përgjithshëm të toksicitetit të metabolitëve M11 dhe M21, që duhet të hetohet më tej për të konfirmuar vlerat e duhura të referencës toksikologjike të zbatueshme për to. Për më tepër, konfirmimi i pranishmësisë së M11 dhe M21 dhe raporti i tyre midis përbërjeve të metconazole të monohidroksiluar në kultura, me qëllim që të konfirmohet përkufizimi i mbetjeve për vlerësimin e rrezikut.

**3. ZGJATEN AFATET E REGJISTRIMIT PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:****• Deri më 15 shtator 2026:**

1. S-abscisic acid
2. Amisulbrom

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.

• Deri më 1 mars 2027:

1. Valifenalate
2. Thiencarbazone

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.

Totali: 4 (katër) lëndë vepruese.

4. HIQEN LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:**1. Acibenzolar-S-methyl**

Miraimi i lëndës vepruese acibenzolar-S-methyl tërhiqet.

Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë acibenzolar-S-methyl, brenda datës 10 janar 2025.

Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë acibenzolar-S-methyl, të përfundojë brenda datës 10 korrik 2025.

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

VENDIM

Nr. 120, datë 10.7.2024

**AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE “FONDI PËR
NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA
DHE TË MESME PËR VITIN 2024”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|----------|
| - Z. Blendi Gonxhja | kryetar; |
| - Znj. Mimoza Dhëmbi | anëtare; |
| - Znj. Brikena Qela | anëtare; |
| - Znj. Keida Qirko | anëtare; |
| - Z. Ahmet Mançellari | anëtar, |

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 10.7.2024, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, mori në shqyrtim njoftimin e skemës së ndihmës shtetërore të njoftuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) e mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

I. Procedura

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me shkresën nr. 903/1, datë 2.7.2024 ka njoftuar skemën e ndihmës shtetërore “Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2024”. Në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e ndihmës shtetërore, në bazë të planit të ndihmës shtetërore të sipërpërmendur.

II. Përshkrimi i masës

2. *Qëllimi:* akordimi i granteve synon mbështetjen e projekteve që nxitin rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, inovacionin dhe rinovimin e teknologjisë, zhvillimin e biznesit kreativ, si dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse me qëllim nxitjen drejt eksportit.

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 466, datë 30.7.2021, “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve dhe të planit të veprimit për periudhën 2021–2027”, si dhe në zbatim të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” është përcaktuar se me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin



e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, krijohet fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve, i cili financohet nga buxheti i shtetit. Fondi përdoret për dhënien e granteve për NMVM-të, me qëllim zbatimin e programeve që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë, artizanatit, zhvillimin e të mësuarit rreth ndërmarrjes, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja si rezultat i kërkim-zhvillimit, zhvillimin e aftësive të ndërmarrjes, inovacionin, rinovimin e teknologjisë, ndërkombëtarizimin e zhvillimin e NMVM-ve dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse. Fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve administrohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka ndërmarrë iniciativën për hartimin e këtij projektvendimi për vitin 2024.

3. *Baza ligjore e planit të ndihmës*: plani i ndihmës shtetërore mbështetet në paragrafin 2, të nenit 9, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” dhe VKM-së nr. 408, datë 19.6.2024, “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2024”.

4. *Kobëzgjatja*: skema e ndihmës do të zbatohet gjatë vitit 2024.

5. *Dhënësi i ndihmës*. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

6. *Autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës*: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

7. *Përfituesit*: përfitues janë të gjithë aplikantë përfitues të kategorisë ndërmarrje mikro, e vogël dhe e mesme. Aplikuesit për përfitimin e fondit plotësojnë kriteret e përgjithshme të përcaktuara në pikën 5 të ligjit nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, si dhe kriteret e veçanta të lidhura me projektplanin e biznesit, si më poshtë:

- përputhshmërinë e planit të biznesit me objektin dhe qëllimet e dhënies së fondit, duke pasur në fokus nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të NMVM-ve, lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm;

- saktësinë dhe objektivitetin e planit të biznesit, elemente të cilat identifikohen nëpërmjet rezultateve të matshme nga realizimi i tij;

- përshkrimin e aktiviteteve që do të realizohen, i cili duhet të jetë i detajuar dhe i qartë;

- qartësinë e përshkrimit të impaktit dhe rezultateve të matshme;

- të dhëna konkrete që aktivitetet e ndërmarrjes rritin numrin e të punësuarve;

- të dhëna konkrete dhe të argumentuara për impaktin pozitiv mjedisor.

8. *Shtirja sektoriale dhe territoriale*: projekti do të zbatohet në territorin e Republikës së Shqipërisë në të gjithë sektorët e ekonomisë.

9. *Forma dhe vlera e ndihmës*:

- Skema e mbështetjes financiare për shpenzimet korrente të programit ekonomik (04130) “Mbështetje për zhvillimin ekonomik” të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, është në vlerën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë. Fondi mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

- Skema e mbështetjes financiare për shpenzimet kapitale, që përdoret për mbështetjen e projekteve të investimeve, të programit ekonomik (04130) “Mbështetje për zhvillimin ekonomik” të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është në vlerën 51 830 000 (pesëdhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë mijë) lekë, ndarë si më poshtë vijon:

- projekte për inovacionin, në vlerën 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë;

- projekte për konkurrueshmërinë, në vlerën 21 830 000 (njëzet e një milionë e tetëqind e tridhjetë mijë) lekë, mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

- projekte për *start-up*-et, në vlerën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 800 000 (tetëqind mijë) lekë;

- projekte në mbështetje të artizanatit, në vlerën 5 000 000 (pesë milionë) lekë, mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 800 000 (tetëqind mijë) lekë.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

10. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis



shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

11. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdoq formë e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

12. Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹ përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

13. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) përzgjedhja; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

14. Plani i ndihmës aktivizon burime shtetërore që do të zbatohet nga AIDA financohet me burimet shtetërore, buxheti i shtetit. Skema i jep një avantazh përfituesve në formën e granteve direkte, të cilin ndërmarrjet nuk do ta kishin përfituar në kushte normale të tregut. Avantazhi i dhënë nga skema është selektiv, pasi do të jepet vetëm për ndërmarrjet të caktuara, të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara në paragrafin 7. Skema mund të shtrembërojë konkurrencën, pasi forcon pozicionin konkurrues të përfituesve të skemës, si edhe ndikon në tregtinë përfshirë dhe ndërkombëtare, si përfitues që operojnë edhe në sektorë në të cilët ekziston tregtia në rajon.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për

ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, plani në shqyrtim është ndihmë shtetërore, e cila është e ndaluar përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

15. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, i cili parashikon:

“Ndihma “De minimis” është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.”

Mbështetur në kreun II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “De minimis”, vlera maksimale e lejuar e ndihmës, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës përcaktohet si vijon:

1. Ndihma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;

b) ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Në kreun III “Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit”, të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, përcaktohet se: “1. Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente”.

Sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe VKM-në nr. 605/2016, ndihma “De minimis” lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet duke qenë se ndihma shtetërore për një ndërmarrje është deri në vlerën 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë;

b) ndihma duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Kohëzgjatja e skemës, e

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës
Faqe| 16288

së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre Anëtare”.



cila është marrë në shqyrtim, është një vit, duke plotësuar këtë kusht ligjor;

c) ndihma është transparente. Ky kusht plotësohet sepse ndihma jepet në formën e grantit.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 8/1, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit “Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2024”, të miratuar me VKM-në nr. 408, datë 19.6.2024, “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kritereve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2024”.

2. Çdo përfitues i ndihmës duhet të nënshkruaj deklaratën e ndihmës “*De-minimis*” dhe të dorëzoj një kopje të deklaratës pranë AIDA.

3. AIDA brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Kryetar: Blendi Gonxhja

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Brikena Qela, Keida Qirko, Ahmet Mançellari

KËRKESË

Nr. 77/13, datë 29.7.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikonstruksion i rrugëve ‘Faik Pajuni’ dhe ‘Alush Lleshanaku’ në ZK 8521, Bashkia Elbasan’”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 1,698,683.8 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre pikë tetë) lekësh.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Elbasan.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Elbasan, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,698,683.8 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre pikë tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMIT
Kastriot Gurra



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI
“RIKONSTRUKSION RRUGËVE ‘FAIK PAJUNI’ DHE ‘ALUSH LLESHANAKU’ NË ZK 8521”, ELBASAN

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM											SHËNIME (D+E) (duftime hipotekare, banë mbi pasuritë etj.)		
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose qyteti	Zona katastrale	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	"Arë" (m ²)	"Truall" (m ²)	"Ndërtesë" (m ²)	Volumi	Faqe	"ARË"			"TRUALL"			"NDËRTESË"			Vlera e kulturës historike dhe druftimore sipas procesverbalit të Drejtorisë së Rrugëve			VLERA TOTALE (tëkë)	
														Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (tëkë/m ²)	Vlera (tëkë)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (tëkë/m ²)	Vlera (tëkë)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (tëkë/m ²)	Vlera (tëkë)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (tëkë/m ²)			Vlera (tëkë)
A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	Y	Z				
1	BEQIR NEKTAR SOPOT DHURATA DASHAMIRA	BUKUROSH BUKUROSH BUKUROSH BUKUROSH BUKUROSH	SEJDINI SEJDINI SEJDINI SEJDINI SEJDINI	ELBASAN	8521	3/486	TRUALL	150	0	150	0	0	0	0	0	0	84.3	13666	1152043.8	0	0	0	0	0	1152043.8		
2	BESNIK	SHAZIVAR	MUZHAKI	ELBASAN	8521	3/225	TRUALL	40	0	40	0	0	0	0	0	0	40	13666	546640	0	0	0	0	0	546640		
3			SHITET	ELBASAN	8521	3/583	TRUALL	8311.7	0	8311.7	0	0	0	0	0	0	2305	0	0	0	0	0	0	0	0		
SHUMË																								1070683.8			
Çmimet për pasuritë e lloji arë+truall janë marrë nga harta e vlerës, miratuar me VKM-në nr. 89, datë 3.2.2006																											



NJOFTIM

Nr. 292/32, datë 30.7.2024

PËR SHPËRBLIMIN NË NATYRË

Ky njoftim iu drejtohet të gjithë pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken nga realizimi i projektit “Për zbatimin e projektit të ‘Portit të ri tregtar të integruar të Durrësit në Porto-Romano’, për mundësinë e kompensimit të pasurisë në pronësi të tyre me shpërblim në natyrë”.

Subjekti kërkues i procedurës së shpronësimit për realizimin e këtij projekti është Autoriteti Portual Durrës.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të shpronësohen me një pasuri tjetër të paluajtshme, në pronësi të shtetit, se shpërblimi në natyrë kryhet:

- nëpërmjet shkëmbimit të pasurisë, pronë private, që shpronësohet me një pasuri tjetër të paluajtshme, në pronësi të shtetit me të njëjtën vlerë me pasurinë që shpronësohet; si dhe

- nëpërmjet kombinimit të formës së shpërblimit në vlerë financiare me shkëmbimin në natyrë të pasurisë, pronë private, që shpronësohet me një pasuri të paluajtshme në pronësi të shtetit, sipas rasteve të parashikuara në këtë vendim, bazuar në gerrat “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 3, si dhe në zbatim të pikës 5, të nenit 6, të vendimit nr. 797, datë 28.12.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rasteve dhe të rregullave për shpërblimin në natyrë të shpronësimeve për interes publik”.

Në zbatim të pikës 4, të nenit 2, të VKM-së nr. 797, datë 28.12.2023, “Për përcaktimin e rasteve dhe të rregullave për shpërblimin në natyrë të shpronësimeve për interes publik”, në çdo rast, shpërblimi në natyrë realizohet vetëm pasi të merret pëlqimi i subjektit që shpronësohet, pëlqimi duhet të jetë unanim nga të gjithë bashkëpronarët të cilët duhet të dakordësojnë midis tyre për shpërblimin në natyrë.

Në rast se ky kusht nuk plotësohet, mungesa e dakordësisë për dhënien e pëlqimit për trajtimin me

shpërblim në natyrë nga ana e subjektit që do të shpronësohet nuk e pengon vijimin e procedurës së shpronësimit, pasi kompensimi i pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, në këtë rast do të bëhet me vlerë financiare, të parashikuar sipas shpronësimit klasik, në zbatim të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, ASHSH-ja informon të gjithë të interesuarit që preken nga zbatimi i projektit të “Portit të ri tregtar të integruar të Durrësit në Porto-Romano”, për mundësinë e kompensimit të pasurisë në pronësi të tyre që preket nga shpronësimi për interes publik me shpërblim në natyrë me qëllimin informimin mbi mundësinë për trajtimin me shkëmbim në natyrë, në respektim të parimit të shpërblimit të drejtë, duke garantuar transparencë, barazi, mbrojtjen e interesave dhe të të drejtave të tyre pasurore.

Me shpalljen e njoftimit publik në Fletoren Zyrtare për trajtimin me shkëmbim të pronarëve të pasurive pronë private të cilët do të shpronësohen, në rast se qytetarët shprehin interesin e tyre për trajtimin me shkëmbim në natyrë, të pasurive në pronësi të tyre, ASHSH-ja vlerëson, se pronarët e pasurive që kërkohen për shpronësim, si dhe personat e tretë të interesuar, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar bashkëlidhur kërkesës për shpronësim publik nr. 374/9, datë 27.7.2023, të publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 111, datë 27.7.2023, **jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga publikimi i këtij njoftimi** kanë të drejtë të depozitojnë kërkesën e tyre për trajtimin me shkëmbim në natyrë pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, me qëllim ndjekjen më tej dhe finalizimin e procedurave të shpronësimit, në zbatim të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve ligjore të VKM-së nr. 797, datë 28.12.2023, “Për përcaktimin e rasteve dhe të rregullave për shpërblimin në natyrë të shpronësimeve për interes publik”.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 112 lekë